

KMSHC-DAP, takim të përbashkët pune

Zbatimi i ligjit për nëpunësin civil ishte kryefjala e takimit të mbajtur sot, me iniciativën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), gjatë fjalës së saj, vlerësoi bashkëpunimin institucional me Departamentin e Administratës Publike.

Gjatë takimit u theksua nevoja për koordinimin e sistemeve të kompjuterizuara të dy institucioneve, me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit mbikqyrës, unifikimi i praktikës në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore, për rikthimin në punë të nëpunësve civilë, gjyqfitues, me qëllim respektimin e të drejtave të tyre dhe reduktimin e dëmit ekonomik në buxhetin e shtetit.



Në fokus të diskutimeve ishin edhe ndryshimet në ligjin “Për nëpunësin civil”, ku Komisioneri, parashtroi disa mendime, në funksion të këtij procesi.



Në përmbyllje të takimit, të dy institucionet u angazhuan për ngritjen e grupeve të përbashkëta, në funksion të hartimit të akteve nënligjore, pas miratimit të ndryshimeve në ligj, si dhe për të bashkëpunuar edhe për aspekte të tjera në fushën e administrimit të shërbimit civil.